

Prishtinë 2.11.2006
ERO D_21_2006

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Nenin 15.1 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë në lidhje me përgjegjësitë e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për krijimin dhe zbatimin e një kornize rregullative në sektorin e energjisë në Kosovë, e cila do të sigurojë mos-diskriminimin, konkurrencën efektive dhe funksionimin e tregut të energjisë.
2. Përgjegjësinë e ZRRE-së për të monitoruar ndarjen e organizimit, vendimmarrjen dhe format e kontabilitetit për ndërmarrjet energjetike;
3. Neni 26 i Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë në lidhje me kompetencat e ZRRE-së për të nxjerrë akte dhe vendime individuale.
4. Aplikacionin për ndryshimin e Vendimit Nr. D_10_2006 “Udhëzimet mbi Themelimin e Kufinjve të Pronësisë dhe ata Komercialë midis Shoqërive Aksionare”, paraqitur në ZRRE nga KOSTT (Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut SHA) nxjerrë më 3.02.2006;

Në një takim të mbajtur më 2 nëntor 2006, ka vendosur të ndryshojë Vendimin Nr. D_10_2006 në mënyrë që të:

- a) Apropojë pikën 1 të aplikacionit të dorëzuar nga KOSTT;
- b) Refuzojë pikën 2 të aplikacionit të dorëzuar nga KOSTT.

Pjesa 1: Baza Ligjore

- 1.1. Bazuar në mandatin ligjor, në përputhje me Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë, ZRRE-ja ka nxjerrë Vendimin Nr. D_10_2006 “Udhëzim mbi Themelimin e Kufirit të Pronësisë dhe atij Komercial midis Shoqërive Aksionare”.
- 1.2. KOSTT ka aplikuar për ndryshime të Vendimit të mësipërm, në nenet 5 dhe 6 si vijon:
 - a) Neni 5 i Vendimit do të aplikohet dhe për Rrjetin e Shpërndarjes së KEK-ut në mënyrë që të përcaktojë kufirin e qartë midis KOSTT dhe Rrjetit të Shpërndarjes së KEK-ut;
 - b) Neni 6 a) duhet të modifikohet për të përfshirë TS Podujevën bazuar në modelin e ndarjes së aseteve që është e bashkangjitur në Vendimin Nr. D_10_2006;

Pjesa 2: Shpjegimi

- 1.1. Bordi i ZRRE-së ka shqyrtuar aplikacionin dhe dokumentet shoqëruese
- 1.2. Neni 5.1 i Vendimit Nr. D_10_2006 do të ndryshohet nga fjala “shpërndarje“. Neni i ndryshuar 5.1 tani lexon: “Ndarja e pronësisë midis gjenerimit, shpërndarjes dhe rrjetit të transmisionit,

përcaktohet nga PIKA E KYÇJES, e cila sipas këtij udhëzimi ... ; Pjesa tjetër e Nenit mbetet e pandryshuar.

- 1.3. Pika 2 e aplikacionit nuk është aprovuar meqenëse modeli i ndarjes së aseteve që përfshihen në vendimin D_10_2006, është i pasaktë dhe do të zëvendësohet nga një tjetër që do t'i bashkëngjitet këtij Vendimi.

Pjesa 3. Aplikueshmëria

- 3.1. Ky vendim do të botohet nga KOSTT në faqen e tij elektronike, brenda pesë (5) ditëve punuese pas njoftimit dhe botimit të Vendimit nga ZRRE-ja.
- 3.2. Ky Vendim është i aplikueshëm prej datës së nxjerrjes dhe publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së.

Kryesues i Bordit të ZRRE-së
Dr Nick Frydas

Anëtarët e Bordit
